

# Komunikatë për media lidhur me testimin e antarëve të KF Prishtina

IKSHPK ka qenë në kontakt të afërt me menaxhmentin e KF Prishtina gjatë muajit të fundit me qëllim të ofrimit të shërbimeve të testimit për SARS-CoV-2 për antarët e saj.

Me kërkesën e KF të Prishtinës fillimisht me datën 05.08.2020 janë testuar 34 antarë të saj nga të cilët shtatë kanë rezultuar pozitiv, testim ky i kryer para fillimit të përgatitjeve për ndeshjen në Gjibraltari. Gjithashtu me datën 15.08.2020 janë testuar 44 antarë të KF Prishtina nga të cilët nëntë kanë rezultuar pozitiv. Pas rritjes së tyre me datën 16.08.2020, tre kanë rezultuar pozitiv, nga të cilët dy ishin të raste të reja të konfirmuara (përveq atyre të datës 05.08.2020). Me datën 19.08.2020 janë testuar 40 antarë të KF Prishtina, nga të cilët 9 rezultuan pozitiv.

Në bazë të kësaj kronologjie të testeve vërehet se infeksioni me COVID 19 ka qarkulluar në mesin e antarëve të KF Prishtina në javët e fundit. Është shumë e mundur që rastet të cilat nuk janë detektuar me datën

15.08.2020 në

IKSHPK kanë qenë në fazën e hershme të infeksionit dhe për këtë arsye

potencialisht kanë rezultuar pozitive me datën 17.08.2020 gjatë mostrimit në Gjibraltar.

Duhet theksuar se rreziku për paraqitje të rasteve të reja në mesin e antarëve të klubit gjatë ditëve pas testimeve të kryera ka qenë dhe

është i pranishëm duke marrë në konsiderim faktin që inkubimi gjatë infeksionit

është 2-14 ditë dhe të gjithë antarët kanë qenë në kontakte të afërta të

rasteve të konfirmuara.

IKSHPK me kërkesë të KF Prishtina sot, me datën 20.08.2020, ka kryer

testimin për prani të SARS-CoV-2 te antarët e ekipit të dytë të Prishtinës dhe nga

27 të testuar një ka rezultuar pozitiv dhe për këto rezultate është informuar menaxhmenti

i KF të Prishtinës.

---

**Të vazhdojnë masat e distancimit fizik dhe mbajtja**

# e maskave!

Të vazhdojnë masat e distancimit fizik dhe mbajtja e maskave!

Të nderuar qytetarë!

Lehtësimi i lëvizjes nuk nënkupton mosrespektimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Mbani distancën fizike dhe mbani maska në vendet publike.

Ju lutemi për kujdes të shtuar deri në shuarjen e plotë të COVID-19!

Ju lutemi të keni kujdes sepse akoma ekziston rrezik i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve.

Virusi nuk ka këmbë, andaj mos ia jepni këmbët e juaja sepse do të rrezikoni të gjithë e më së shumti të afërmit tuaj!

Luten institucionet për mbajtjen e rendit dhe inspektoratet për angazhim të shtuar gjatë ditëve në vijim.

**QYTETARË TË NDERUAR!**

JU LUTEMI TË RESPEKTONI MASAT E SHPALLURA TË PARANDALIMIT NGA  
INSTITUTI KOMBËTAR DHE MINISTRIA E SHËNDETËSISË!

RUAJENI SHËNDETIN TUAJ! PAKUJDESIA KUSHTON ME JETË!

AKOMA NUK KA KALUAR RREZIKU, ANDAJ:

QËNDRONI NË SHTËPI, KJO UA SHPËTON JETËN!  
MBANI DISTANCË FIZIKE PËR SË PAKU 2 METRA!

NA NDIHMONI PAK QË TË JU NDIHMOJMË SHUMË!

Ju faleminderit për mirëkuptim!

---

## **KATËRDHJETË E TRE TË SHËRUAR DHE KATËR RASTE ME COVID-19!**

KATËRDHJETË E TRE TË SHËRUAR DHE KATËR RASTE ME COVID-19!

Sot më 06 maj 2020 janë testuar gjithsej 324 mostra të marra nga Klinika Infektive, rastet nga terreni dhe në Shtëpinë e Përkujdesjes për të moshuar në Prishtinë.

Me SARS-CoV-2, janë diagnostikuar katër (4) raste. Rastet pozitive janë raste kontakti nga: komuna e Prizrenit 2 raste (sipas vendbanimit: 1 rast Prizren, 1 rast Zhur), një 1 rast me vendbanim në Rahovec dhe një 1 rast Leposaviq.

Sot më 06 maj 2020, janë shëruar 43 pacientë. Numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 533 raste.

Nga data 08 shkurt deri më 06 maj 2020 janë testuar gjithsej 9.085 mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2, prej tyre pozitive rezultojnë gjithsej 860 raste, me gjithsej 26 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese.

Në IKSHPK në vazhdimësi përgjatë 24 orëve janë duke u kontaktuar dhe mbikëqyrë të gjitha kontaktet e rasteve, si dhe kontaktet e kontakteve duke i obliguar për vetëizolim dhe të kërkojnë ndihmë mjekësore nëse kanë simptome.

Në nivel global, nga data 31 dhjetor 2019 deri më 06 maj 2020 sipas Worldometers, janë raportuar gjithsej 3.788.005 raste të COVID-19 dhe 261.901 raste të vdekjes.

**QYTETARË TË NDERUAR!**

**JU LUTEMI TË RESPEKTONI MASAT E SHPALLURA TË PARANDALIMIT NGA INSTITUTI KOMBËTAR DHE MINISTRIA E SHËNDETËSISË!**

**JU LUTEMI PËR KUJDES! RUAJENI SHËNDETIN TUAJ!**

**PAKUJDESIA KUSHTON ME JETË!**

AKOMA NUK KA KALUAR RREZIKU, ANDAJ:

QËNDRONI NË SHTËPI, KJO UA SHPËTON JETËN!  
MBANI DISTANCË FIZIKE PËR SË PAKU 2 METRA!  
NA NDIHMONI PAK QË TË JU NDIHMOJMË SHUMË!

Ju faleminderit për mirëkuptim!

---

# UDHËZUES I PËRKOHSHËM PËR APLIKIMIN E MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E COVID-19 NË INSTITUCIONE PUBLIKE DHE PRIVATE

[UDHEZUES I PERKOHSEM APLIKIMI I MASAVE COVID 19 INSTITUCIONET  
PUBLIKE E PRIVATE](#)Download

---

**kosova.health**

Për më shumë, klikoni në foto:

